



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE
BORDI I ADMINISTRIMIT**

VENDIM

Nr. 27, date 29.07.2020

MBI

“MIRATIMIN E NUMRIT TË PERSONELIT AKADEMIK TË FTUAR (ME KONTRATË ME KOHË TË PJESSHME DHE ME NORMË TË REDUKTUAR), NË UNIVERSITETIN E ARTEVE, PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021”

Bordi i Administrimit i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenet 3, 38, 39 dhe 62 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe Vendimin e Senatit Akademik nr. 36, datë 28.07.2020, duke qënë se punësimi i personelit akademik me kohë të pjesshme në Arsimin e Larte bëhet me konkurrim publik, pas procedurës së shpalljes së konkurseve dhe të procesverbaleve të Fakulteteve, si dhe nisur nga ngarkesat mesimore për punonjës të ftuar mësimorë me anë të shkresave për Fakultetin e Muzikes, për Fakultetin e Arteve të Bukura me nr. 42/1 prot., date 14.07.2020 dhe për Fakultetin e Artit Skenik me nr. 98 prot., date 09.07.2020 dhe pasi shqyrtoi dokumentacionin e përcjellë nga të tre Fakultetet e Universitetit të Artevedhe pasi e diskutoi, me votim të hapur,

V E N D O S I:

1. Miratimin e numrit paraprak të personelit akademik të ftuar, me kontratë me kohë të pjesshme dhe me normë të reduktuar, për vitin akademik 2020-2021, si dhe numrin e punonjësve me kontratë sipas kërkesave të ndryshme të sektorëve, përcjellë nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në total 200 (dyqind) punonjës, sipas lidhjeve bashklidhur këtij vendimi, për secilin Fakultet, si më poshtë:
 - Fakulteti i Muzikës në total 144 punonjës me kontratë me kohë të pjesshme dhe me normë të reduktuar;
 - Fakulteti i Arteve të Bukura në total 19 punonjës me kontratë me kohë të pjesshme dhe me normë të reduktuar;



